

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA Ariana Lukaj

PROZA LETRARE E ERNEST KOLIQIT

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2022

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"
FACULTY OF FILOLOGY



MA Ariana Lukaj

ERNEST KOLIQUI'S LITERARY PROSE

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA Ariana Lukaj

PROZA LETRARE E ERNEST KOLIQIT

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori: Akademik Kujtim Shala

Prishtinë, 2022

REZYME

Veprat e Ernest Koliqit të shkruara në prozë, që në fillim të studimeve më kanë bërë shumë përshtypje, prandaj kjo është arsyeja kryesore, që e kemi zgjedhur veprën e këtij shkrimtari, përkatësisht prozën e tij me titullin "Proza letrare e Ernest Koliqit", si tezë të doktoratës sonë në Programin e Letërsisë të zhvilluar në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Objekti i hulumtimit, analizimit dhe interpretimit të këtij punimi shkencor do të jetë vepra e shkruar në prozë e Ernest Koliqit, e cila do të përfshijë veprat e tij, siç janë: "Hija e maleve" (1929), botuar në Zarë, "Pasqyrat e Narçizit" (1934), botuar në Bari e Romë, "Tregtar flamujsh" (1935), botuar në Tiranë, romanin "Shija e bukës së mbrume", së pari është botuar pjesë-pjesë te revista "Shejzat", ndërsa si vepër integrale është botuar më 1960 në Romë, si dhe dramat "Rrajët lëvizin" (1965) dhe "Takimi i orës 9 të mbrëmjes" (1965).

Në prozë shkroi dy libra me tregime "Hija e maleve" dhe "Tregtar flamujsh", si dhe romanin "Shija e bukës së mbrume", ndërsa teksti, i cili mbeti midis poezisë dhe prozës është "Pasqyrat e Narçizit".

Në librin "Hija e maleve" i qëndron shumë besnik traditës së popullit shqiptar, sepse ngërthen në vete elementet kryesore, që janë të lidhura me jetën dhe mentalitetin shqiptar.

Libri "Tregtar flamujsh" është libër me tregime, i cili i përmbahet traditës shqiptare, por jo në nivelin e traditës së mirëfilltë, siç ishte në librin me tregime "Hija e maleve".

Simboli kombëtar rreth, të cilit bashkohen të gjithë shqiptarët është flamuri.

Boshtin e librit "Tregtar flamujsh" e përbëjnë atdhetarizmi i rrejshëm, zemërimi, gëzimi i madh, ndeshemi me njeriun e pashkolluar, i cili e urren njeriun e shkolluar, ballafaqohemi me mentalitetin e ashpër shqiptar, i cili i ka dhënë gjithmonë përparësi djalit në krahasim me vajzën, ndeshemi me mikpritjen e shqiptarëve etj.

Për dallim nga librat me tregime "Hija e maleve" dhe "Tregtar flamujsh", të cilat janë shkruar në prozë "Pasqyrat e Narçizit" gjendet midis poezisë dhe prozës.

Në romanin "Shija e bukës së mbrume" ndeshemi me vlerat patriotike, shoqërore, morale kryesisht të mjedisit shqiptar, pavarësisht, prej asaj se ku ndodhet personazhi kryesor i romanit "Shija e bukës së mbrume" në atdhe, apo në mërgim.

Duke bërë një krahasim midis librit me tregime "Hija e maleve" dhe personazhit Dodë, si dhe romanit "Shija e bukës së mbrume" dhe personazhit Jorgji Koja e vërejmë se në prozat e shkurtra Koliqi depërton thellë në psikën e intelektualëve, që janë shkolluar jashtë vendit, por që janë rikthyer në atdhe për të sjellë dije e ide të reja.

Në romanin "Shija e bukës së mbrume" Koliqi shpalos psikën e intelektualit, që nuk mund të rikthehet në atdhe për arsye të ndryshme dhe në këtë mënyrë kemi të bëjmë me gjendjen shpirtërore dhe psikologjike të njeriut të mërguar.

Intelektuali shqiptar, i cili jeton në Shqipëri, pra mësuesi Dodë qëllim kryesor e ka krijimin e një kulture të re në mjediset shqiptare duke kërkuar braktisjen e zakoneve, që janë shumë të mbrapshta, por në anën tjetër, pa i mohuar anët më pozitive të traditës, ndërsa intelektuali, i cili jeton në tokë të huaj ka për qëllim kryesor ruajtjen e traditave zakonore shqiptare nga asimilimi i një kulture të huaj me të cilën janë çdo ditë në kontakt dhe në këtë mënyrë ka synuar të krijojë një identitet kombëtar.

Jorgji Koja është intelektuali, i cili është shkolluar jashtë atdheut, por është personazh shumë autentik.

Personazhet e Ernest Koliqit janë personazhe tipike shqiptare, por edhe fryma, e cila hetohet në veprat e tij është fryma tipike e shqiptarizmit.

Temën, të cilën e kemi zgjedhur ta trajtojmë mendojmë, që është trajtuar nga të tjerët, si në poezi, ashtu edhe në prozë, por ne kemi vendosur ta trajtojmë vetëm prozën, por në mënyrë më të zgjeruar.

Gjithmonë ka diçka, që nuk është thënë, apo nuk është shkruar, por që mund të thuhet e të shkruhet ndryshe.

Fjalët kyçe:

Ernest Koliqi, besa, mikpritja, hakmarrja, nderi, zana, orët, shtojzovallet etj.

SUMMARY

His works written in prose, which at the beginning of my studies have impressed me so much is the main reason we chose the writer's work, namely his prose entitled "The Literary Prose of Ernest Koliqi" as a thesis of our doctorate in the Literature Program developed at the Faculty of Philology at the University of Prishtina "Hasan Prishtina".

The object of the research, analysis and interpretation of this scientific paper will be the work written in Ernest Koliqi's prose, which will include his works, such as "The Shadow of the Mountains" (1929) published in Zare, "The Mirrors of Narciz" (1934), published in Bari and Rome, " Flag Trader "(1935), published in Tirana, the novel " The taste of the Bread" was first published in the "Shejzat" magazine, while as an integral work was published 1960 in Rome, as well as the dramas "Moving Races" (1965) and "9am Evening Meeting" (1965).

Koliqi in prose wrote two works of stories "Shadow of Mountains" and "Flag Trader" as well as the novel "The taste of the bread ", while Koliqi's text, which remained between poetry and prose is "Mirrors of Narcissus".

In the book "Shadow of the mountains" it remains very faithful to the tradition of the Albanian people, because it contains the main elements that are connected to Albanian life and mentality.

The "Flag Trader" is an act that adheres to the Albanian tradition, but not to such a level of genuine tradition, as it was in the "Shadow of the Mountains".

As we all know, the entire national symbol around which all Albanians join is the flag.

In the novel "The taste of the Bread" Koliqi discloses the psychic of the intellectual, who cannot return home for various reasons and in this way we are dealing with the spiritual and psychological state of the exiled person. The Albanian intellectual who lives in Albania, the Dodë teacher, has the main purpose of creating a new culture in the Albanian environments by demanding the abandonment of very evil customs, but on the other hand, without negating the more positive sides of the tradition , while the intellectual who lives in foreign lands aims to preserve the customary Albanian traditions from the assimilation of a foreign culture with which they are daily in contact and thus has aimed at creating a national identity.

Jorgji Koja is an intellectual who is educated outside the homeland, so is a very authentic personage.

The characters of Ernest Koliq are typical Albanian characters, but the spirit, which is investigated in his works, is the typical spirit of Albanianism.

The topic we chose, we think it was treated by others, both in poetry and prose, but we have decided to treat only the prose, but in a wider way. There is always something that has not been said or written, but can be said and written differently.

Key words:

Ernest Koliqi, the word given, hospitality, revenge, honorary, fairy, hours, sylph etc.